



REPUBLIKA E ALBANI  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Udhëzues

ASCAP, 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4747 / 2 prot.

Tiranë, më 04.08.2023

MIRATOHET



MINISTËR  
EVIS KUSHI

UDHËZUESI “RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE”

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## **Ky dokument u hartua nga:**

Gerti Janaqi

Teuta Çobaj

Eniana Veli

Majlinda Ucaj

Ndihmuan me ide dhe materiale Shkëlqim Allkaj, Dorina Rapti, Jetmir Aliçka, Mirela Berisha, Ezmeralda Xheraj, Shemsi Muça, Mira Kotobelli, Gjergji Vangjeli, Selman Hodaj, Erida Koleci, Sulejman Keta, Edlir Tërpo, Entela Burazeri, Ekelejda Alizoti, Oriana Osmani, Majlinda Ziu, Alma Laçi, Brunilda Boriçi, Albana Bushati, Roland Dervishaj, Trandafille Guni, Nimete Gjermani.

## **Redaktues shkencor:**

Eniana Veli

Majlinda Ucaj

## **Redaktues gjuhësor:**

Nikolin Gërmenji

Oriana Osmani

## **Shtypshkronja**

**ISBN**

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	5
<b>I.</b> RENDITJA E VLERËSIMIT TË ECURISË SË GJIMNAZEVE .....	7
I.1. Gjimnazet e suksesshme .....	12
<b>II.</b> PARIMET E RENDITJES KOMBËTARE TË GJIMNAZEVE .....	14
<b>III.</b> TREGUESIT E RENDITJES SË GJIMNAZEVE .....	15
<b>IV.</b> VLERËSIMI I TREGUESVE TË RENDITJES SË GJIMNAZEVE .....	16
<b>V.</b> METODOLOGJIA E RENDITJES SË GJIMNAZEVE .....	19
V.1. Infrastruktura .....	19
V.2. Vlerësimi i mësuesve në provimet e kualifikimit .....	23
V.3. Shtrirja e kurrikulës .....	25
V.4. Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënimit .....	26
V.5. Mirëqenia e nxënësve .....	28
V.6. Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të MSh .....	30
V.7. Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të MSh .....	32
V.8. Ruajtja e notës mesatare e lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të nxënësve të klasës së 12-të në provimet e MSh .....	33
V.9. Shkalla e diplomimit .....	34
V.10.Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga shkolla dhe nxënësi .....	37

---

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

V.11. Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar .....	39
V.12. Ruajtja e notës mesatare të gjimnazit nga nxënësit me/mbi notën 9-të në përfundim të vitit të parë të universitetit .....	41
<b>VI. RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE .....</b>	<b>43</b>
VI.1. Kalendari i veprimtarive .....	45
<b>VII. BAZA LIGJORE .....</b>	<b>46</b>
<b>VIII. BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>50</b>
<b>IX. SHTOJCA .....</b>	<b>52</b>
IX:1. Formati i vlerësimit të infrastrukturës së gjimnazit .....	52
IX.2. Formati i vlerësimit të treguesve të gjimnazit nga ZVAP .....	54
IX.3. Anketa për treguesin “Mirëqenia e nxënësve” .....	57
IX.4. Anketa për treguesin “Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar” .....	62

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## HYRJE

Çdo nxënës e meriton një arsimim cilësor, një e drejtë e siguar edhe me ligj në Republikën e Shqipërisë. MAS nëpërmjet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar realizojnë vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, që ofrojnë gjimnazet mbi bazën e treguesve zyrtarë.

Renditja e vlerësimit të performancës së gjimnazeve në nivel kombëtar, realizon një transparencë të bazuar në llogaridhënie ndaj përfituesve të shërbimit arsimor, promovon përhapjen e praktikave të suksesshme dhe njëkohësisht informon palët e interesuara.

Renditja kombëtare e gjimnazeve mbështetur në vlerësimin e performancës së gjimnazeve, në vijim “Renditja e gjimnazeve” është një dokument që përmban “një bateri treguesish sinergjik” të hartuara për të identifikuar realitetin e qartë e të paanshëm, kompleks dhe relativ të veprimtarisë mësimore – edukative të gjimnazeve.

*Renditja e gjimnazeve është krijuar për të ofruar informacion sistematik (1 herë në 3 vjet) mbi efektivitetin e çdo gjimnazi në veçanti dhe të gjithë gjimnazeve në tërësi.*

*Kjo renditje synon të krijojë një “platformë” për mbledhjen, përpunimin, vlerësimin e të dhënave mbi kulturën, konsideratën për këtë shkollë dhe konkurrencën arsimore, bazuar në situatën aktuale, duke siguruar një bazë kërkimore dhe analizë të të dhënave kryesisht për zhvillim të qëndrueshëm të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve për çdo gjimnaz.*

Renditja e gjimnazeve vë në dukje ndikimin dhe ndryshimet në përparimin e gjimnazit me gjimnazet e tjera, në mënyrë që ai të mësojë më shumë nga ato me performancë më të lartë, si dhe të përmirësojë konkurrencën e tij në të ardhmen.

*Platforma plotësohet nga ASCAP-i në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

të arsimit parauniversitar (ZVAP). Renditja kombëtare e gjimnazeve shpallet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), në ceremoninë e shkollave të suksesshme.

Mënyra e llogaritjes dhe përpunimi i të dhënave bazohet në parimet e drejtësisë, paanshmërisë, përgjegjësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit. Renditja e gjimnazeve bëhet e ditur, për ta bërë atë më të besueshme, transparente dhe llogaridhënëse për nxënësit, prindërit, mësuesit, drejtuesit dhe komunitetin.

Të dhënat e platformës së renditjes së gjimnazeve janë të vlefshme për drejtuesit dhe mësuesit e gjimnazit që të njohin anë të veçanta të shkollës që kanë nevojë për më shumë vëmendje, për t'i përfshirë në planet zhvillimore të tyre, si dhe për vendimmarrësit që të bëjnë parashikimet në mënyrë eficiente dhe efikase për rezultatet e ardhshme, për të synuar zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimit bazë për çdo nxënës, përforcimin e individualitetit të çdo nxënësi, tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, si dhe përgatitjen për arsimin e mëtejshëm të tyre ose për tregun e punës.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## I. RENDITJA E VLERËSIMIT TË ECURISË SË GJIMNAZEVE

Ekziston një mendësi e përhapur që numrat pasqyrojnë gjendjen e arsimit, pasi njerëzit besojnë se numrat flasin më shumë se argumentet. Megjithatë, numrat janë të vlefshëm, por jo të gjithëfuqishëm. Numrat janë abstraksione, me koston e një sasi të caktuar të humbjes së informacionit. Numrat janë përpunim digjital që bazohen në supozime të caktuara, të cilat kanë koston e "injorimit të konkretes objektive" deri në një farë mase.

Gjykimi me numrat duhet të bazohet në një logjikë të caktuar të shkaqeve, të cilat ndikohen nga subjektiviteti në një farë mase i interpretimit të tyre. Vlerësimi ndikohet edhe nga faktorë subjektivë. Domethënë, është e pamundur që çdo tregues të jetë njëqind për qind objektiv. Vlera e këtyre të dhënave është se janë fakte të pamohueshme dhe të matshme. Këto fakte duhet të njihen dhe respektohen, por nuk duhen idealizuar, duke mos e humbur gjykimin para tyre.

Të dhënat statistikore janë të matshme dhe të gjurmueshme dhe shërbejnë si një tregues themelor në renditjen e vlerësimit të ecurisë së gjimnazeve, megjithatë, rezultati përfundimtar i tyre nuk është një gjykim mbi “*fuqinë*” apo “*dobësinë*” e përgjithshme të secilit gjimnaz në vlerë absolute.

Treguesit arsimorë cilësorë dhe sasiorë japin një pasqyrë të përgjithshme, por jo shteruese të cilësisë së shërbimit arsimorë që ofron një gjimnaz. Ato janë një përshkrim i situatës aktuale në të cilën janë kryer matjet apo është realizuar vlerësimi për këtë gjimnaz.

Në procesin e vlerësimit të renditjes së gjimnazeve, në mënyrë të pashmangshme humbasin disa informacione për shkak të disa faktorëve të brendshëm, kështu për shembull: vijimësia dhe zhvillimi i ecurisë së shkollës në të ardhmen do të ndikohet nga numri i nxënësve, por ky mund të mos jetë i vetmi faktor që përcakton të ardhmen e saj.

Të dhëna objektive dhe faktike përafrohen sa më shumë që të jetë e mundur, por është e pamundur të përcaktohet me saktësi të madhe e ardhmja e shkollave të veçanta, ashtu si vlerësimi i shëndetit të njeriut nuk mund të përcaktojë me saktësi jetëgjatësinë individuale.



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Vlera më e madhe në procesin e renditjes së gjimnazeve, do të jetë, nëse të gjitha gjimnazet, veçanërisht ato të suksesshme, mund ta shohin renditjen e vlerësimit të performancës *me një qëndrim të hapur dhe vetë-ekzaminues*. Synojmë që kjo renditje të bëhet një bazë e të dhënave të burimeve të përbashkëta digjitale me vlerë të qëndrueshme, duke ofruar një platformë referimi për rritjen e konkurrencës së natyrshme dhe gjithëpërfshirëse ndërmjet gjimnazeve, si dhe njëkohësisht, për të përmbushur kriteret e cilësisë të përcaktuara në Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës ASCAP, 2020.

Logjika bazë e vlerësimit të ecuresisë së gjimnazeve është, para së gjithash, përcaktimi i treguesve të vlerësimit gjithëpërfshirës, të cilët duhet të përdoren, si dhe aq sa është e mundur, si shprehje përfundimtare e konkurrueshmërisë mes tyre, për të treguar rezultatet e epërsisë në konkurrencë. Treguesit e vlerësimit matin drejtpërdrejt se cili gjimnaz ka një konkurrencë më të fortë.

Treguesit e vlerësimit të konkurrencës ndahen në dy kategori: njëra ka ata tregues që mund të maten drejtpërdrejt; tjetra ka treguesit që varen nga faktorë, të cilët janë të vështirë të maten drejtpërdrejt, si për shembull: mjedisi i të nxënësve, filozofia e mësimdhënies dhe e të nxënësve, niveli i drejtimit dhe menaxhimit, popullariteti i gjimnazit etj.

Faktorët që nuk mund të analizohen drejtpërdrejt pasqyrohen nga disa tregues të matjes jo të drejtpërdrejtë, të cilët përgjithësisht arrihen nëpërmjet formave të ndryshme të anketave apo pyetësorëve me grupe të ndryshme.

Natyrisht, rezultati mund të pasqyrojë vetëm forcën e fazës aktuale të konkurrueshmërisë të gjimnazit dhe jo njëqind për qind të situatës së vërtetë të konkurrencës. Prandaj, është e nevojshme të kemi edhe një lloj tjetër treguesi, përkatësisht *treguesin analitik të konkurrencës*, për të vlerësuar në mënyrë sa më objektive konkurrencën arsimore.

Për këtë arsye, zhvillohen një “*sërë treguesish të konkurrencës*” për t’i dhënë një pamje sa më gjithëpërfshirëse efektivitetit të një gjimnazi të caktuar. Këta tregues lidhen në mënyrë logjike së bashku për të paraqitur pamjen e përgjithshme dhe modelin e lidhjes së zbatuar, ilustrimin e funksionimit në tërësi të arsimit të përgjithshëm.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Modelet konceptuale ose metodat për zhvillimin e treguesve arsimorë konkurrues mbështeten në teori dhe literaturë të konsiderueshme bashkëkohore. Si të tilla, mund të përmendim gjashtë metodat<sup>1</sup> për studimin e treguesve arsimorë, përkatësisht: metoda e “input/output”, metoda e “procesit”, metoda e “organizimit”, metoda e “vlerësimit”; metoda<sup>2</sup> e “induksionit”, metoda “eksperimentale”, si dhe modelin<sup>3</sup> e “konsumit dhe prodhimit të treguesve”; ku mbështetet përzgjedhja e treguesve arsimorë.

Renditja kombëtare e vlerësimit të performancës së gjimnazeve është bazuar te modeli “Input-Proces-Rezultat”, pasi mbulon tre komponentët kryesorë konkurrues të sistemit arsimor.

1. “Inputi arsimor” përshkruan *konkurrencën mes gjimnazeve në terma të sasisë absolute*. Kjo qasje pohon se rezultatet e nxënësve ndikohen nga sasia dhe cilësia e burimeve arsimore. Në përgjithësi, sa më i madh të jetë kontributi i shkollës, aq më e fortë është konkurrenca. Vlerësimi i “Inputit arsimor” synon të japë informacion dhe të përcaktojë si përdoren burimet njerëzore, burimet e teknologjisë digjitale, mjetet dhe materialet didaktike-mësimore, mjedisi fizik, në planifikimin, zbatimin dhe përvetësimin e kurrikulës.
2. “Procesi arsimor” përshkruan *konkurrencën mes gjimnazeve në ana e sasisë relative*. Kjo qasje përfshin në pjesën më të madhe punën e stafit mësimor dhe jomësimorë. Rritja e madhësisë së shkollës (numri i nxënësve) nuk do të thotë domosdoshmërisht se kjo shkollë ka një performancë të nivelit të lartë. Vlerësimi i cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve si dhe të mirëqenies së nxënësve, synon të përcaktojë përputhshmërinë ndërmjet veprimtarive të synuara dhe ato të realizuara, në raport me kriteret e cilësisë, me programet lëndore dhe me nivelet e arritjeve.
3. “Rezultati arsimor” pasqyron *potencialin e gjimnazit*. Vlerësimi i arritjeve akademike, i veprimtarive jashtëshkollore dhe i kënaqësisë së shërbimit të ofruar, synon të mbledhë të dhëna për të përcaktuar nëse produkti përfundimtar i kurrikulës, që po përdoret tani u mundëson nxënësve zgjedhje individuale, sipas nevojave dhe interesave të tyre.

---

<sup>1</sup> Averch et al. (1971)

<sup>2</sup> Yamamoto (1978)

<sup>3</sup> Baker (1978)

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Shpresohet që në të gjitha gjimnazet të ketë lidhje reciproke ndërmjet tre komponentëve input-proces-rezultat, për ta bërë konkurrencën sa më gjithëpërfshirëse. Konkurrenca e reflektuar nga tre komponentët është e ndryshueshme. Për shembull, në disa gjimnaze, “Inputi arsimor” është komponent shumë i fortë, por “Procesi arsimor” dhe “Rezultati arsimor” janë komponentë shumë të dobët; ndërsa në gjimnaze të tjera “Procesi arsimor” është i fortë, edhe pse “Inputi arsimor” është i dobët.

Është vënë re se në disa gjimnaze që kanë përdorur kriteret përzgjedhjeje për regjistrimin e nxënësve, duke monopolizuar burimet e nxënësve (kriteri i lartë i notës hyrëse) për një kohë të gjatë, si rezultat kanë pasur input arsimor të fortë, por ecuria e rezultatit arsimor të tyre ka lënë për të dëshiruar (nuk ka shënuar rritje), kurse disa gjimnaze që kanë pasur input arsimor të dobët, janë rritur krejtësisht vetëm nëpërmjet përmirësimit të procesit arsimor.

Disa gjimnaze në fazën e rritjes mund të mos kenë “Input arsimor” dhe “Proces arsimor” të fortë, por “Rezultati arsimor” i tyre, tregon një prirje të rritjes së shpejtë, me rezultate pozitive nga viti në vit, gjë që duhet të vlerësohet më shumë se një gjimnaz tjetër në po të njëjtat kushte, por që mban të njëjtin nivel arritjeje.

Kjo mënyrë e vlerësimit të gjimnazeve mbështetet jo vetëm te arritjet e tyre akademike dhe vlerësimet në provimet kombëtare apo pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare, pra, jo vetëm përmes rezultatit arsimor, por edhe te procesi arsimor, përfshirja e nxënësve në jetën e shkollës, vëmendja që i kushton interesave të secilit prej nxënësve të tij, vlerësimi dhe menaxhimi i drejtë i të gjitha burimeve arsimore dhe mbi të gjitha, krijimi i një kulture demokratike dhe gjithëpërfshirëse në shkollë, si parakusht për një mjedis cilësor të edukimit.

*Vetëm analiza e ndërthurur e të gjithë treguesve të konkurrencës është në gjendje të japë një imazh të realitetit tërësor të rezultateve të një gjimnazi.*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Modeli “Input-Proces-Rezultat” plotëson edhe kriteret e përzgjedhjes së treguesve, pasi:

- siguron prova të mjaftueshme për t'u kuptuar lehtësisht nga përdoruesit në të gjitha nivelet, duke shmangur përdorimin e treguesve të përbërë ose kompleks;
- ndihmon për të përshkruar funksionimin aktual dhe efektivitetin e mësimdhënies dhe të të nxënit të gjimnazeve;
- mat karakteristikat e qëndrueshme gjatë procesit mësimor, duke ndihmuar drejtuesit se ku të përqendrohen në të ardhmen;
- përballon kohën dhe ndihmon vendimmarrësit që të bëjnë parashikime të arsyeshme për rezultatet e ardhshme.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## I.1. GJIMNAZE TË SUKSESSHME<sup>4</sup>


Gjimnazet e suksesshme në këtë renditje tregojnë se kjo nuk ndodh rastësisht. Gjimnazet e suksesshme kanë drejtues vizionar, të guximshëm, agjentë të ndryshimit, të cilët kanë aftësinë për të krijuar dhe frymëzuar ekipe, anëtarët e të cilëve punojnë vazhdimisht për nxënësit dhe komunitetin, të cilëve u shërbejnë.

Ekziston një bindje e pasionuar në këto gjimnaze se të gjithë të rinjtë mund të ndihmohen të përmbushin potencialin e tyre dhe të bëhen të suksesshëm. Asnjë sfidë nuk konsiderohet si e pakapërcyeshme; në të vërtetë, ato gjenerojnë përgjigje novatore dhe efektive. Stafit është i besuar dhe i përgjegjshëm. Ata janë të motivuar, kënaqen me punën e tyre dhe kanë qasje në një mori mundësish për t'u zhvilluar si profesionistë.


Gjimnazet kanë respektin dhe besimin e fituar me vështirësi të komuniteteve të tyre. Dhe më e rëndësishmja është se të rinjtë dalin të sigurt dhe të aftë, të pajisur mirë për fazën tjetër të jetës së tyre, për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Të gjithë drejtuesit në analizën e gjimnazit të tyre ngrenë vazhdimisht tri pyetje:

- Si ia arritën ata ta bëjnë gjimnazin të suksesshëm?
- Si e mbajnë atë nivel të lartë?
- Ku do të shkojnë në të ardhmen?


Para së gjithash duhet të dimë që një gjimnaz është i suksesshëm përkatësisht kur:




“Drejtori dhe ekipi i fortë drejtues kanë krijuar sisteme dhe struktura shumë efektive për rritjen e standardeve.”




“Një shkollë e shkëlqyer, kultura e së cilës është e përqëndruar në arritjet e nxënësve dhe cilësinë e përvojave të të nxënësve të tyre.”



“Prodhon nxënës të arrirë, me arritje të larta e ambiciozë, si dhe të pajisur më së miri e në të gjitha aspektet për tu bërë pjesë në shoqërinë moderne.”



“Është një shkollë ku ka një ndjenjë të përbashkët ambicioze që ndahet nga të gjithë nxënësit.”



“Nxënësit bëjnë përparim të jashtëzakonshëm. Shkolla përpiqet fort dhe është ambicioze për suksesin e tyre.”

<sup>4</sup> Citime të drejtorëve të shkollave të mesme të suksesshme në Angli, <https://dera.ioe.ac.uk/11232/2/ Twelve.pdf> (20 21)

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

- ✓ ka vizion, vlera dhe pritshmëri të larta, gjithmonë në ndryshim;
- ✓ emëron, mban dhe zhvillon stafin në vijimësi duke ruajtur një kulturë të fortë ekipore dhe sjellje të qëndrueshme;
- ✓ siguron përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënësve, nëpërmjet kërkimit të mënyrave të reja të planifikimit, zbatimit dhe përvetësimit të kurrikulës përkatëse, për të plotësuar nevojat dhe interesat e nxënësve;
- ✓ përfshin të gjithë nxënësit si individë unikë, pavarësisht nga karakteristikat individuale të moshës, origjinës sociale, gjinisë dhe nivelit të arritjeve në hyrje;
- ✓ vlerëson në përputhje me nivelet e arritjeve, duke përcjellë përparimin;
- ✓ ndërton dhe udhëheq marrëdhëniet drejt suksesit me nxënësit, prindërit, komunitetin dhe komunitet e tjera shkollore.

Në mënyrë që gjimnazet të ruajnë nivelin dhe të realizojnë pritshmëritë/kriteret e cilësisë të përcaktuara në Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020, më shumë se çdo gjë tjetër ato duhet të përqendrohen në gjërat që i bëjnë ato shumë mirë dhe në radhë të parë në ruajtjen e moralit dhe kulturës së duhur, duke siguruar që mësimdhëniet të jetë e një standardi të lartë të vazhdueshëm, sigurimin që sjellja të menaxhohet mirë, si dhe gjimnazi të jetë i qetë dhe i rregullt.

Ç’është më e rëndësishmja, drejtuesit e gjimnazeve të suksesshme kuptojnë gjithashtu se sa mundësi ka shkolla e tyre për të mbështetur inovacionin dhe zhvillimin, duke punuar në mënyrë aktive për ta forcuar atë. Gjithashtu, ata nuk kanë frikë të rrezikojnë, rreziqet që ato marrin janë të llogaritura dhe të vlerësuara drejt.

“Shkolla tregon një dëshirë për përmirësim të vazhdueshëm, sidomos nga grupi udhëheqës dhe ekipi i stafit, që janë jashtëzakonisht efektivë.”

“Qëllimisht është krijuar një atmosferë entuziazmi që karakterizon të gjitha aspektet e punës në shkollë.”

“Në qendër të suksesit të saj është vendosmëria e paepur nga të gjithë pjesëtarët në komunitetin e shkollës për të dhënë më të mirën e tyre.”

“Është një shkollë e shkëlqyer, që ofron një mjedis të rregullt brenda të cilit nxënësit lulëzojnë.”

“Një shkollë e shkëlqyer që ka treguar përmirësim të vazhdueshëm e është në rrugën e duhur për të vazhduar me tej.”

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## II. PARIMET E RENDITJES KOMBËTARE TË GJIMNAZEVE

- ✓ Renditja e gjimnazeve realizohet një herë në tri vjet, nga ASCAP-i në bashkëpunim me MAS-in, DPAP-në, DRAP-et dhe ZVAP-të.
- ✓ Renditja e gjimnazeve përfshin gjimnazet publike dhe ato private.
- ✓ Renditja e gjimnazeve bëhet në nivel kombëtar në tri grupime, përkatësisht:
  - gjimnazet publike;
  - gjimnazet private;
  - gjimnazet ndërkombëtare.
- ✓ MAS-i, ASCAP-i, DPAP-ja, DRAP-et dhe ZVAP-të publikojnë në faqen e tyre zyrtare të internetit renditjen kombëtare të gjimnazeve.
- ✓ MAS-i organizon ceremoninë për vlerësimin e gjimnazeve më të suksesshme.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## III. TREGUESIT E RENDITJES SË GJIMNAZEVE

TREGUESIT E RENDITJES SË GJIMNAZEVE			
Komponentët	Pesha	Treguesit	Pesha
Inputi arsimor	15%	Infrastruktura	5%
		Vlerësimi i mësuesve në provimet e kualifikimit	5%
		Shtrirja e kurrikulës	5%
Procesi arsimor	35%	Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve	25%
		Mirëqenia e nxënësve	10%
Rezultatet arsimore	50%	Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të maturës shtetërore	5%
		Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të MSh	5%
		Ruajtja e notës mesatare e lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të nxënësve të klasës së 12-të në provimet e MSh	10%
		Shkalla e diplomimit	10%
		Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga gjimnazi dhe nxënësit	5%
		Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar	5%
		Ruajtja e notës mesatare të gjimnazit nga nxënësit me/mbi notën 9-të në vitin e parë të universitetit	10%

*Për nxënësit e gjimnazeve ndërkombëtare, të cilët japin provimet ndërkombëtare, të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në vend të notave të Maturës Shtetërore, merren si referencë notat e këtyre provimeve, të njehsuara sipas udhëzimit zyrtar.*



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## IV. VLERËSIMI I TREGUESVE TË RENDITJES SË GJIMNAZEVE

Vlerësimi i treguesve të renditjes së gjimnazeve realizohet nga ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-et dhe ZVAP-të.

*Detyrat dhe përgjegjësitë:*

### ASCAP-i

- ✚ realizon në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-et, ZVAP-të dhe vlerësuesit kombëtarë të certifikuar vlerësimin e fushës “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve” (në vlerësime të plota apo tematike);
- ✚ realizon pyetësorët me 20% të nxënësve për të vlerësuar mirëqenien e tyre;
- ✚ realizon pyetësorët me 20% të prindërve për të vlerësuar kënaqësinë e tyre ndaj shërbimit arsimor të ofruar nga gjimnazi që ndjek fëmija i tyre;
- ✚ në bashkëpunim me MAS, ZVAP-të dhe universitetet, llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e nxënësve me mbi notën 9-të, sipas VKM-së, që kanë ruajtur notën mesatare të gjimnazit në përfundim të vitit të parë të universitetit;

### DPAP-ja

- ✚ mbështet dhe bashkëpunon me ASCAP-in për realizimin e vlerësimit të fushës “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve” (në vlerësime të plota apo tematike);
- ✚ mbështet dhe bashkëpunon me ASCAP-in për realizimin e pyetësorëve me 20% të nxënësve për të vlerësuar mirëqenien e tyre;

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	<ul style="list-style-type: none"><li>mbështet dhe bashkëpunon me ASCAP-in për realizimin e pyetësorëve me 20% të prindërve për të vlerësuar kënaqësinë e tyre ndaj shërbimit arsimor të ofruar nga gjimnazi që frekuenton fëmija i tyre;</li><li>monitoron dhe/ose inspekton ZVAP-të për vlerësimin e saktë treguesve për renditjen e gjimnazeve.</li></ul>
<b>DRAP-i</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>monitoron ZVAP-të për vlerësimin e saktë të treguesve për renditjen e gjimnazeve;</li><li>inxhinieri i DRAP-it bashkëpunon me ZVAP-në për vlerësimin e treguesit të infrastrukturës.</li></ul>
<b>ZVAP-ja</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>cakton një specialist përgjegjës për vlerësimin e infrastrukturës së gjimnazit, i cili në bashkëpunim me inxhinierin e DRAP-it, llogarit përqindjen e përmbushjes së standardeve zyrtare nga çdo gjimnaz, në përputhje me VKM-në 319, datë 12.04.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të IAP-ve” (i ndërtuar apo i ristrukturuar pas daljes së VKM-së);</li><li>llogarit përqindjen e mësuesve që janë vlerësuar “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë” në provimin e fundit të kualifikimit të mësuesve, për çdo gjimnaz;</li><li>llogarit për çdo gjimnaz, përqindjen e lëndëve me zgjedhje të ofruara nga gjimnazi në klasën e 12-të, kundrejt lëndëve me zgjedhje sipas planit mësimor, të dokumentuara nga formularët e plotësuar prej nxënësve;</li><li>llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të MSh;</li><li>llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e nxënësve të vlerësuar me/mbi</li></ul>

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të MSh;

- ✚ llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e nxënësve të klasës së 12-të që kanë ruajtur notën mesatare të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore
- ✚ llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e shkallës së diplomimit të nxënësve, krahasuar me nxënësit e regjistruar në klasën e 10-të të tri viteve të mëparshme;
- ✚ llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e çmimeve kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga gjimnazi dhe nxënësit, krahasuar me numrin e çmimeve të mundshme;
- ✚ llogarit për çdo gjimnaz ndërkombëtar rezultatet e nxënësve në provimet IB (<http://www.ibo.org>), AP, A Level; ([https://www.paneli\\_i\\_kolegjit.org](https://www.paneli_i_kolegjit.org)), duke i njehsuar sipas udhëzimit zyrtar.

## V. METODOLOGJIA E RENDITJES SË GJIMNAZEVE

Të dhënat për vlerësimin e treguesve për renditjen e gjimnazeve që plotësohen nga ZVAP-ja, merren nga rezultatet e vitit të kaluar shkollor, ndërsa “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve” dhe pyetësorët me nxënësit dhe prindërit realizohen nga ASCAP-i çdo tri vjet.

Të dhënat për vlerësimin e treguesve që i kërkon ZVAP-ja gjimnazit, plotësohen vetëm nga drejtori i tij, i cili mban përgjegjësi për plotësimin e saktë të tyre.

Gjatë përlogaritjes së vlerës së treguesve, përqindjet rrumbullakosen dhe shënohen me dy shifra pas presjes dhjetore.

### V.1. Treguesi: Infrastruktura

Gjimnazi është një mjedis ku nxënësit kalojnë një pjesë të madhe të kohës, si i tillë ai duhet të ofrojë një klimë mikpritëse, që të krijojë mundësi shoqërizimi dhe përkatësie.

Infrastruktura e gjimnazit duhet të jetë në përputhje me VKM-në 319, datë 12.04.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të IAP-ve”.

Përmbushja e standardeve të infrastrukturës ndikon drejtpërdrejt në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave themelore të nxënësve.

Gjimnazi duhet të plotësojë standardet zyrtare në lidhje me:

- shëndetin/higjienën (ujë i rrjedhshëm dhe i pastër, cilësia e ajrit, ndriçimi, ngrohja/ftohja e shkollës etj.);
- sigurinë (rrethimi i oborrit, kangjellat, gjerësia e shkallëve, fiksja e zjarrit, kutia e ndihmës së shpejtë, shkallët e emergjencës, rampa etj.);
- përshtatjen e mjediseve mësimore në funksion të mësimdhënies dhe nxënies (raporti nxënës-hapësirë);
- laboratorët (fizikë, biologji, kimi, TIK), bibliotekën, këndin sportiv, palestrën;

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

- mjetet dhe materialet mësimore edukative.

Për vlerësimin e këtij treguesi përdoret “Formati i vlerësimit të infrastrukturës së gjimnazit”, i cili është mbështetur në VKM-në 319, datë 12.04.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të IAP-ve”. Formatit<sup>5</sup> përbëhet nga 35 standarde, të cilët vlerësohen nga 0 deri në 1 pikë, sipas përmbushjes së tij. Ky tregues vlerësohet nga specialisti i ZVAP-së në bashkëpunim me inxhinierin e DRAP-it,

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e plotësimit të standardit zyrtar të infrastrukturës, me peshën 5% të këtij treguesi, pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Gjimnazi “A” është vlerësuar nga ZVAP-ja, si më poshtë:

Nr.	Formati për vlerësimin e infrastrukturës së gjimnazit	Pikë
1.	Gjimnazi është i rrethuar me kangjella/mur.	1
2.	Mjedisi i jashtëm i gjimnazit është i mirëmbajtur, i gjelbëruar dhe shplodhës.	1
3.	Klasat janë me sipërfaqe jo më të vogël se 1.4-1.6 m <sup>2</sup> për nxënës.	1
4.	Hapësirat e tavolinave të nxënësve dhe distanca mes tyre, janë sipas standardeve.	0.7
5.	Qëndrimi dhe ulja e nxënësve në klasë nga rreshti i parë te dërrasa është jo më pak se 2 m <sup>2</sup> .	0.8
6.	Këndi i të parit të nxënësit është jo më shumë se 30°.	0.8
7.	Klasat ndriçohen me dritë natyrore të mjaftueshme në krahun e majtë të nxënësve.	1
8.	Sipërfaqja e dritareve të klasave zë 1/5 ose 1/6 të sipërfaqes së dyshemesë.	0.9

<sup>5</sup> Formatit i vlerësimit të infrastrukturës së gjimnazit gjendet në shtojcën e këtij udhëzuesi.

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

9.	Gjimnazi ka klasa laboratorike (kimi, biologji, fizikë, informatikë, gjuhë e huaj) me hapësirë jo më pak se 2.2 m <sup>2</sup> për nxënës, ku janë ekspozuar rregullat e sigurisë.	0.8
10.	Laboratorët/kabinetet janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe materialet mësimore-didaktike.	0.8
11.	Gjimnazi ka mjedis biblioteke me sipërfaqe jo më pak se 0.15 m <sup>2</sup> për nxënës.	1
12.	Gjimnazi ka mjedise multifunkionale (sallë mbledhjesh/takimesh/simpoziumesh).	0.3
13.	Gjimnazi ka sallë (palestër) për edukimin fizik e cila është jo më e vogël se 405 m <sup>2</sup> .	0.7
14.	Gjimnazi ka 2 mjedise të vetë-ndihmës (veshje/zhveshje) me sipërfaqe 20 m <sup>2</sup> secila.	1
15.	Gjimnazi ka sallë aktivitetestesh për nxënësit, e cila është 0.25m <sup>2</sup> /nxënës dhe jo më pak se 70 m <sup>2</sup> .	0
16.	Gjimnazi ka hapësirë administrative për drejtorin, e cila është jo më pak se 25 m <sup>2</sup> .	1
17.	Gjimnazi ka hapësirë administrative për nëndrejtorin, e cila është jo më pak se 16 m <sup>2</sup> .	1
18.	Gjimnazi ka sallë mësuesish me sipërfaqe jo më pak se 30 m <sup>2</sup> .	0.7
19.	Gjimnazi ka zyrë sekretarie me sipërfaqe jo më pak se 16 m <sup>2</sup> .	1
20.	Gjimnazi ka mjedis të veçantë për personelin ndihmës, i cili është 2 m <sup>2</sup> për çdo person.	1
21.	Gjimnazi ka dhomë për ofrimin e shërbimit mjekësor, me sipërfaqe jo më pak se 17 m <sup>2</sup> .	0.5
22.	Gjimnazi ka mjedis të veçantë për ofrimin e shërbimit psiko-social me sipërfaqe minimale 18 m <sup>2</sup> .	1
23.	Mjediset komunikuese, hyrjet, hollet, korridoret, shkallët, rampa janë sipas standardeve zyrtare.	0.8
24.	Gjimnazi ka impiantin e furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë sanitar.	1
25.	Gjimnazi ka impiantin e shkarkimit të ujërave të zeza, ujërave të shiut dhe	1

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	ujërave të bardha.	
26.	Gjimnazi ka hapësira të jashtme të mjaftueshme për zbatimin e kërkesave të kurrikulës së edukimit fizik (fushë volejball, basketbolli, futboll, tenisi dhe kënd gjimnastikor).	0.5
27.	Orenditë dhe pajisjet (tavolinat, karriget, stolat, dërrasat e shkrimit, dollapët lavamanët, njësitë fikse të mureve, ventilatorët e avujve, veglat dhe pajisjet laboratorike, kompjuterët, printerët, skanerët, kolltukët, varësit special për harta dhe fotografi, pajisjet audovizuale etj.), janë sipas karakteristikave dhe përmasave të projektimit të ndërtesës së gjimnazit.	0.9
28.	Ndërtesa e gjimnazit siguron qasjen e papenguar të lëvizjes, qëndrimit dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta.	1
29.	Numri i tualeteve është në raport me numrin e nxënësve dhe të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta.	0.5
30.	Gjimnazi ka impiantin e mbrojtjes kundër zjarrit (SMKZ) dhe mjete portative (bombola) për shuarjen e zjarrit.	1
31.	Gjimnazi ka impiantin e ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit.	0.35
32.	Gjimnazi ka shkallë emergjence në çdo kat.	0
33.	Në mjediset e gjimnazit janë vendosur shenja dalluese dhe udhëzues mbi veprimet përkatëse në rast ngjarjesh të jashtëzakonshme, si dhe janë afishuar në mjediset e tij numrat e emergjencës (policisë, zjarrfikëses dhe të urgjencës).	1
34.	Mjediset e brendshme dhe të jashtme të gjimnazit nuk janë të zëna me objekte që pengojnë lëvizjen e nxënësve në ngjarje të jashtëzakonshme.	1
35.	Gjimnazi ka afishuar në mjediset e tij shenjat dalluese që ndalojnë pirjen e duhanit, pijeve alkoolike, drogës dhe përdorimin e telefonit celular në të gjitha mjediset e tij.	1
<b>Pikë totale</b>		<b>28.05</b>

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Secili standard është vlerësuar nga 0 pikë deri në 1 pikë, sipas përmbushjes së tij, si p.sh., standardi “Laboratorët/kabinetet janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe materialet mësimore-didaktike”, është vlerësuar me 0.8 pikë, pasi gjimnazi “A” disponon 80% të mjeteve dhe materialeve mësimore-didaktike.

Gjimnazi “A” është vlerësuar me 28.05 pikë nga 35 të mundshme, d.m.th., përmbush 80,14% të standardeve të përgjithshme zyrtare të infrastrukturës.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

Përqindja e plotësimit të standardeve zyrtare të infrastrukturës	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
80.14	5%	$80.14 \times 5 / 100 = 4$

*Pikët totale 4 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## V.2. Vlerësimi i mësuesve në provimet e kualifikimit

Kualifikimi i mësuesve është proces, i cili organizohet për mësuesit që plotësojnë vjetërsinë 5, 10 dhe 20 vjet punë dhe që kanë të drejtë të përfitojnë shkallët e kualifikimit: *Mësues Mjeshtër* (kategoria I), *Mësues Specialist* (kategoria II) dhe *Mësues i Kualifikuar* (kategoria III). Mësuesit vlerësohen sipas shkallëve të cilësisë: “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët”.

Sa më i lartë të jetë vlerësimi i mësuesve në provimin e kualifikimit, aq më shumë rritet cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit në gjimnaz.

*Mësuesit, të cilët kanë fituar kategorinë I (mësues mjeshtër) para 2012, klasifikohen me vlerësimin “Shumë mirë”.*



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

*Vlera e treguesit gjendet nga shumëzimi i përqindjes së mësuesve të vlerësuar “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë” në provimin e fundit të kualifikimit të secilit, me peshën 5% të këtij treguesi, e pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Gjimnazi “A” ka 50 mësues, të cilët në provimet e fundit të kualifikimit të secilit mësues janë vlerësuar si më poshtë:

3 mësues (6%)	Shkëlqyeshëm
5 mësues (10%)	Shumë mirë
5 mësues (10%)	Kanë marrë 20 vjeçarin para 2012
21 mësues (42%)	Mirë
7 mësues (14%)	Mjaftueshëm
5 mësues (10%)	Dobët
4 mësues (8%)	Të pakualifikuar

Mësuesit që janë vlerësuar “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë” janë 13 (26%).

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e mësuesve të vlerësuar “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
26%	5%	<b><math>26 \times 5/100 = 1.3</math></b>

*Pikët totale 1.3 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## V.3. Treguesi: Shtrirja e kurrikulës

Kurrikula me zgjedhje zgjidhet nga nxënësi për të plotësuar formimin e tij të përgjithshëm, për të përmbyllur studimet në arsimin e mesëm të lartë, si dhe në funksion të ndjekjes së studimeve në arsimin e lartë.

Shkolla duhet të përpiqet që të përmbushë kërkesat mbizotëruese të nxënësve, duke ju ofruar një shtrirje (gjerësi dhe thellësi të përmbajtjes) sa më të madhe të kurrikulës me zgjedhje në klasën e 12-të, që lidhet me lëndët me zgjedhje sipas planit mësimor.

*Vlera e treguesit llogaritet duke shumëzuar përqindjen e lëndëve me zgjedhje (pa modulet) që ofron gjimnazi në klasën e 12-të, kundrejt lëndëve sipas planit mësimor, me peshën 5% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

### **Shembull:**

Gjimnazi “A” u ofron nxënësve të klasave të 12-ta, 7 lëndë me zgjedhje, kundrejt 13 lëndëve, sipas planit mësimor. Përqindja e lëndëve me zgjedhje që gjimnazi u ka ofruar maturantëve është  $7/13=53.84\%$ .

Pra, gjimnazi nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e nxënësve për lëndët me zgjedhje.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e lëndëve me zgjedhje që ofron gjimnazi në klasën e 12-të, kundrejt kërkesave të nxënësve</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
53.84%	5%	<b><math>53.84\% \times 5 / 100 = 2.69</math></b>

*Pikët totale 2.69 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## V.4. Treguesi: Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit

Shkolla synon ndërtimin dhe krijimin e aftësive të nxënësit, për t'i përshtatur ata me kërkesat e standardet e reja të kohës, si qytetarë të së ardhmes dhe ndikon në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë, për t'u përballur me sfidat e jetës.

Në Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020, janë përcaktuar pritshmëritë që duhet të përmbushë çdo shkollë në Republikën e Shqipërisë. Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit nënkupton që mësuesit:

- kanë siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë nxënësit, duke realizuar një mësimdhënie dhe nxënie konstruktive, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuar, në situata dhe kontekste mësimore ose jetësore;
- janë bazuar në nevojat vetjake, stilet e të nxënit dhe përvojat mësimore paraprake të të gjithë nxënësve në planifikimin, zbatimin dhe përvetësimin e kurrikulës, për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre;
- kanë siguruar një mësimdhënie të individualizuar, në përshtatje me nevojat e të gjithë nxënësve me kurrikulën, për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave themelore;
- kanë planifikuar dhe zbatojnë kurrikulën zyrtare, duke siguruar barazpeshën mes njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të të nxënit, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, për përvetësimin e saj nga të gjithë nxënësit;
- kanë planifikuar dhe zbatojnë kurrikulën zyrtare, në përputhje me veçoritë kryesore të grupmoshave të nxënësve, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë e nivele të ndryshme arsimore, duke qartësuar nxënësit dhe prindërit;
- kanë planifikuar dhe zbatojnë kurrikulën, duke bashkëpunuar me përgjegjësi me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit e cilësisë së fushës “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve”.

FUSHA 2: CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE E TË NXËNËSIT	
<b>Treguesit e cilësisë</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Planifikimi lëndor është hartuar bazuar në dokumentet kurrikulare, në pikëpamjen pedagogjike të mësuesit dhe në përshtatje me nxënësit e tij.</li><li>2. Mësuesi realizon bashkë me nxënësit projekte lëndore, ndër-lëndore që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat kurrikulare/ndërkurrikulare.</li><li>3. Plani ditor hartohet duke identifikuar objektin/et e të nxënësve dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësve.</li><li>4. Mjedisi i të nxënësve është funksional dhe motivues për të gjithë nxënësit.</li><li>5. Mësuesi dhe nxënësit përdorin një metodologji të përshtatshme për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave.</li><li>6. Mësuesi planifikon detyra shtëpie individuale dhe në grup, si vazhdim i procesit të nxënësve.</li><li>7. Mësuesi realizon vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të demonstruara nga nxënësit në kontekste të ndryshme.</li></ol>

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar normën e vlerësimit, sipas shkallës së vlerësimit të përcaktuar në Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020, në vlerësimin e plotë ose tematik të gjimnazit për 7 treguesit e cilësisë së fushës “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve”, me peshën 25% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## ***Shembull:***

Gjimnazi “A” në vlerësimin e fundit të plotë/tematik, për fushën “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve”, është vlerësuar sipas normës së vlerësimit me 78%.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

Norma e vlerësimit	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
78%	25%	$78 \times 25 / 100 = 19.5$

*Pikët totale 19.5 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## **V.5. Treguesi: Mirëqenia e nxënësve<sup>6</sup>**

Mirëqenia e nxënësve matet nga anketa e zhvilluar me 20% të nxënësve të gjimnazit për të marrë mendimin në lidhje me mirëqenien e tyre. Anketa duhet të ofrojë dëshmi të besueshme, për këtë arsye nxënësit duhet të përzgjidhen në mënyrë rastësore, duke përfshirë nxënës të të gjitha niveleve dhe të të gjitha klasave/paraleleve.

ASCAP-i harton dhe zhvillon anketën në periudhën që realizohet vlerësimi i plotë/tematik i gjimnazit. Anketa nuk duhet të zgjasë më shumë se 15-20 minuta. Ajo zhvillohet nëpërmjet platformave online, gjë e cila lehtëson përpunimin e rezultateve të saj. Aty ku nxënësit nuk kanë mundësi të përdorimit të pajisjeve digjitale personale, i kërkohet gjimnazit t'u mundësojë përdorimin e pajisjeve të shkollës. Nëse edhe kjo nuk është e mundur, atëherë ajo mund të zhvillohet me formularë të printuar.

Grupi i vlerësimit duhet të marrë masa për të mbrojtur identitetin e të gjithë nxënësve të anketuar. Anketa mund të ndryshojë ndër vite sipas përparësive dhe kërkesave të MAS-it.

---

<sup>6</sup> Në shtojcë gjendet anketa për treguesin “Mirëqenia e nxënësve”

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Anketa zhvillohet me nxënësit për tematika të tilla si:

- pjesëmarrjen në veprimtari sportive dhe jashtëshkollore;
- dukurinë e bullizmit dhe dhunës brenda dhe jashtë shkollës;
- gjithëpërfshirjen;
- klimën në shkollë;
- ndjenjën e përkatësisë;
- procesin e mësimdhënies;
- procesin e të nxënit;
- përdorimin e TIK-ut;
- interesin dhe motivimin në shkollë;
- vlerësimin e rezultateve të tyre;
- pjesëmarrjen në vendimmarrjet e gjimnazit;
- marrëdhëniet mësues-nxënës, nxënës-nxënës;
- etj.

*Vlera e këtij treguesi gjendet duke shumëzuar përqindjen e përgjigjeve të nivelit 4 dhe 5 të anketës të zhvilluar me nxënësit, me peshën 10% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë. U realizuan anketa me 20% të nxënësve të gjimnazit. Për të gjetur përqindjen e përgjigjeve të nivelit 4 dhe 5 të anketës të zhvilluar me nxënësit, gjendet mesatarja aritmetike e përqindjes së përgjigjeve, për të cilat nxënësit janë përgjigjur *dakord* dhe *plotësisht dakord*, përkatësisht:

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

$$\text{Përqindja} = \frac{P_1 + P_2 + P_3 + \dots + P_{49} + P_{50}}{50}$$

Ku me  $P_1 + P_2 + P_3 + \dots + P_{49} + P_{50}$ , janë shënuar përqindjet e përgjigjeve të nivelit 4 (*dakord*) dhe 5 (*plotësisht dakord*) të secilit pohim. Nga llogaritjet, rezulton se 87.6% e nxënësve të anketuar janë përgjigjur në nivelin 4 (*dakord*) dhe 5 (*plotësisht dakord*) në lidhje me mirëqenien e tyre.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e mesatares aritmetike të përqindjeve të përgjigjeve të nivelit 4 dhe 5 të anketës me nxënësit</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
87,6%	10%	<b>87.6 x 10/100 = 8.76</b>

*Pikët totale 8.76 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## **V.6. Treguesi: Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të maturës shtetërore**

Matura Shtetërore është një fazë që shënon përfundimin e tri viteve të gjimnazit dhe mat atë që kanë përvetësuar nxënësit.

Matura është një çast vendimmarrës për të ardhmen e të rinjve dhe një dëshmi e rëndësishme si për ata që do të ndjekin universitetin, ashtu edhe për ata që do të marrin pjesë në tregun e punës.

Rezultatet e larta në provimet e maturës u rritin besimin, duke forcuar personalitetin e tyre dhe duke i motivuar për të studiuar më tej. Gjithashtu, rezultatet e larta në provime japin mundësi për të fituar të drejta studimi në universitete brenda vendit dhe ato ndërkombëtare.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në tri provimet e detyruara të maturës shtetërore, në sesionin e parë, me peshën 5% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë. Në provimet e lëndëve bërthamë të maturës shtetërore janë vlerësuar me notën me/mbi 9-të të përshkallëzuar 18 (36%) nxënës në lëndën e gjuhës së huaj, 16 (32%) nxënës në lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe 21(42%) nxënës në lëndën e matematikës.

Përqindja e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet e lëndëve bërthamë të maturës shtetërore në sesionin e parë është:

$$\frac{36\%+32\%+42\%}{3} = 36.67\%$$

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet e detyruara të MSh</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve për këtë tregues</b>
36.67%	5%	<b><math>36.67 \times 5 / 100 = 1.83</math></b>

*Pikët totale 1.83 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## V.7. Treguesi: Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të maturës shtetërore

Provimet e lëndëve me zgjedhje të maturës shtetërore janë vendimtare për drejtimin që do të marrin maturantët dhe plotësimin e zgjedhjeve të tyre në lidhje me programin e studimit që dëshirojnë të ndjekin në universitet.

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të maturës shtetërore në sesionin e parë, me peshën 5% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

### **Shembull:**

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë. Në provimet e lëndëve me zgjedhje janë vlerësuar me notën me/mbi 9-të të përshkallëzuar 29 (58%) nxënës.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të MSh</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
58%	5%	<b><math>58 \times 5 / 100 = 2.9</math></b>

*Pikët totale 2.9 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## V.8. Treguesi: Ruajtja e notës mesatare e lëndët të kurrikulës<sup>7</sup> bërthamë dhe me zgjedhje të nxënësve të klasës së 12-të në provimet e maturës shtetërore

Vlerësimet e provimeve të Maturës Shtetërore janë shumë të rëndësishme, pasi ato janë kriter për pranimin në arsimin e lartë.

Nga analizat e Maturës Shtetërore në nivel vendor, rajonal apo kombëtar, ka rezultuar shqetësuese dukuria që, një nxënës i vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor, në provimin e maturës ka marrë notë më të ulët se 2-3 nota, apo një nxënës që është vlerësuar me notën 6 gjatë procesit mësimor, në provimin e maturës ka marrë notë më të lartë se 2-3 nota.

Kjo ndodh si për arsye të moskorrektësisë në menaxhimin e mjediseve të provimit nga administratorët, ashtu edhe vlerësimin fiktiv nga ana e mësimdhënësve.

Nisur nga ky fakt, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar, gjimnazet duhet të ndërmarrin hapat e duhura, me plane të mirëfillta përmirësimi, për të zvogëluar hendekun e krijuar midis dy rezultateve.

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e mesatares aritmetike të nxënësve që kanë ruajtur notën mesatare të klasës së 12-të të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore, me peshën 10% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

### **Shembull**

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë. Mesatarja aritmetike e numrit të nxënësve që kanë ruajtur notën të klasës së 12-të të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore (gjuhë e huaj, gjuhë shqipe dhe letërsi dhe matematikë) dhe lëndët me zgjedhje me notën e këtyre lëndëve në provimet e maturës shtetërore është 27.

<sup>7</sup> Për këtë tregues merren notat e lëndëve të kurrikulës bërthamë (gjuhë e huaj e parë, gjuhë shqipe dhe letërsi dhe matematikë) dhe lëndët e kurrikulës me zgjedhje përkatëse.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

27

Përqindja e nxënësve është:  $\frac{27}{50} = 54\%$

50

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e nxënësve të klasës së 12-të që kanë ruajtur notën mesatare të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
54%	10%	<b>54x10/100=5.4</b>

*Pikët totale 5.4 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## V.9. Treguesi: Shkalla e diplomimit

Shkalla e diplomimit të nxënësve vlerëson raportin mes numrit të nxënësve të regjistruar në gjimnaz në klasën e 10-të, me numrin e nxënësve të diplomuar në përfundim të maturës. Ky tregues matet duke krahasuar shkallën e pranimit me shkallën e përfundimit (suksesit). Këto dy shkallë janë plotësuese dhe ofrojnë një pamje më të drejtë dhe më të plotë të veprimtarisë mësimore-edukative të gjimnazit.

Shkalla e përfundimit (suksesit) varet nga karakteristikat individuale të nxënësve të pranuar (moshës, origjinës sociale, gjinisë dhe nivelit të shkollës në hyrje të gjimnazit).

Ky tregues vlerëson se çfarë ka bërë gjimnazi për t'i mirëpritur dhe mbështetur këta nxënës, si i ka ndihmuar ata të rritin nivelin e tyre fillestar.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

Shkalla e pranimit bën të mundur raportimin për atë çka ka ndodhur që nga regjistrimi i nxënësit në gjimnaz deri në përfundimin e tij.

Shkalla e përfundimit (suksesit) vlerëson për një nxënës mundësinë që ai të marrë diplomën në fund të një arsimimi të kryer tërësisht në këtë gjimnaz, dhe kjo, pavarësisht nga numri i viteve të nevojshme.

Më saktë, shkalla e suksesit është mundësia, për një nxënës, që të kalojë radhazi nga klasa e 10-të në të 11-të, nga klasa e 11-të në atë të 12-të, nga mbarimi i klasës së 12-të tek hyrja në provimet e maturës dhe diplomimi.

Pavarësisht nga numri i viteve të kërkuara, është e rëndësishme të theksohet se përsëritja e një viti të gjimnazit nuk duhet parë si “dështim”, pasi nxënësi mund të kalojë vitin pasardhës dhe të hyjë në provimet e maturës, si dhe të diplomohet.

Për një gjimnaz të caktuar, nxënësit përsëritës lidhen me nxënësit e regjistruar vitin e kaluar në klasën më poshtë, duke zbritur nga këta nxënës të pranishëm nxënësit që përsërisin një vit në shkollë.

Nxënësit që përsërisin një vit në gjimnaz hiqen nga emëruesi, pasi këta nxënës e kanë ende mundësinë të diplomohen në këtë gjimnaz.

*Si nxënës të larguar llogariten ata që janë transferuar në një gjimnaz, apo shkollë të mesme tjetër brenda qytetit (bëjnë përjashtim nxënësit që janë larguar për arsye objektive, e miratuar kjo nga ZVAP-ja) dhe nxënësit që e kanë ndërprerë gjimnazin, ndërsa nxënësit e ardhur në gjimnaz nuk llogariten.*

Nga ana tjetër, nxënësit që largohen nga gjimnazi nuk hiqen në llogaritjen e shkallës së pranimit dhe në këtë mënyrë e ulin atë, pasi ata nuk do të kenë kurrë mundësi të diplomohen në këtë gjimnaz.

---

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Nëse nxënësit që përsërisin një vit në gjimnaz dështojnë dhe largohen vitin e ardhshëm, në atë moment ata do të ulin shkallën e pranimit. Por, për sa kohë që provojnë sërish dhe qëndrojnë, llogariten si pasuri e gjimnazit.

*Vlera e treguesit gjendet nga shumëzimi i përqindjes së shkallës së përfundimit, me peshën 10% të treguesit, e pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Në gjimnazin “A”, nga 50 nxënës të regjistruar në klasën e 10-të, në vitin shkollor 2019-2020, 42 prej tyre janë diplomuar në vitin shkollor 2021-2022, ndërsa 8 janë larguar ose e kanë ndërprerë gjimnazin.

$$\text{Shkalla e suksesit është: } \frac{42}{50} = 84\%$$

Në gjimnazin “B”, nga 50 nxënës të regjistruar në klasën e 10-të, në vitin shkollor 2019-2020, 41 prej tyre janë diplomuar në vitin shkollor 2021-2022. Nga këta 9 nxënës, 5 prej tyre kanë përsëritur vitin, por vazhdojnë të ndjekin gjimnazin, ndërsa 4 janë larguar ose e kanë ndërprerë gjimnazin.

$$\text{Shkalla e suksesit është: } \frac{41}{50-5=45} = 91\%$$

Gjimnazi “B” ka një shkallë më të lartë sukseesi se gjimnazi “A”, sepse ai i mirëpret dhe i mbështet më mirë në çdo kohë nxënësit e tij.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Gjimnazi	Përqindja e shkallës së diplomimit	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
“A”	84%	10%	$84 \times 10 / 100 = 8.4$
“B”	91%	10%	$91 \times 10 / 100 = 9.1$

Pikët totale 8.4 (për gjimnazin “A”) apo 9.1 (për gjimnazin “B”) tregojnë vlerën e këtij treguesi.

## V.10. Treguesi: Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga shkolla dhe nxënësit

Rritja e konkurrencës në jetë pas mbarimit të gjimnazit, bën të nevojshme që nxënësit të përgatiten për t'u përballur me sfidat që do të vijnë. Konkurset, garat dhe kryesisht olimpiadat janë një ndihmë e madhe në këtë përgatitje, të cilat testojnë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe dhuntinë e një nxënësi.

Olimpiadat, edhe pse sfiduese, janë shumë të rëndësishme për formimin akademik dhe jo akademik të nxënësve, pasi:

- u mundësojnë nxënësve të fitojnë njohuri shtesë përveç programeve të shkollës, por edhe mënyra të ndryshme për të analizuar dhe kuptuar konceptet bazë. Kjo i ndihmon ata për të fituar aftësi të mendimit kritik, arsyetimin logjik për zgjidhjen e problemeve dhe i bën ata të mendojnë në mënyrë analitike, kritike, krijuese dhe të gjithanshme, të cilat janë jashtëzakonisht të dobishme në fazat e mëvonshme të jetës së tyre;
- u japin mundësi nxënësve për të përfaqësuar dhe nderuar shkollën e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- i përgatitin nxënësit për testimet konkurruese të ardhshme;
- u japin mundësi nxënësve të pranohen në universitetet më të mira ndërkombëtare.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Gjithashtu, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve, duke ofruar mundësi të reja praktike për të zhvilluar dhe testuar njohuritë dhe aftësitë e tyre.

*Vlera e këtij treguesi gjendet duke shumëzuar përqindjen e çmimeve të fituara në nivel kombëtar, me peshën 5% të treguesit, e pjesëtuar me 100. Nëse gjimnazi ka fituar çmime ndërkombëtare, vlerës së treguesit i shtohet automatikisht një pikë për çdo çmim ndërkombëtar të fituar.*

## **Shembull:**

Në vitin shkollor 2022-2023, në nivel kombëtar janë zhvilluar 8 olimpiada (matematikë, gjuhë shqipe dhe letërsi, fizikë, kimi, biologji, histori, gjeografi dhe informatikë) dhe janë zhvilluar 2 konkurse me tematika të ndryshme, ku për secilën janë shpallur 3 vende fituese, përkatësisht 30 çmime të mundshme. Po ashtu, MAS-i ka shpallur 10 thirrje për gjimnazet për të aplikuar në projekte të ndryshme.

Numri total i çmimeve të mundshme që mund të fitojnë nxënësit dhe gjimnazi është 40.

Ndërkohë, gjimnazi “A” ka fituar një projekt në nivel shkolle dhe nxënësit e tij kanë arritur të fitojnë 4 çmime, duke u renditur në tri vendet e para në tri olimpiada dhe një konkurs.

Numri i çmimeve të fituara nga gjimnazi “A” është 5.

Përqindja e çmimeve të fituara nga gjimnazi kundrejt çmimeve të mundshme është  $5/40=12.5\%$ .

Ndërkohë, një nxënës i gjimnazit ka fituar edhe një çmim në nivel ballkanik.

Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e çmimeve të fituara me peshën 5% të treguesit, e pjesëtuar me 100.

Numrit total të pikëve i shtohet 1 pikë për çmimin e fituar në nivel ndërkombëtar.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e çmimeve në nivel kombëtar</b>	<b>Numri i çmimeve ndërkombëtare</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
12.5%	1	5%	$(12.5 \times 5 / 100) + 1 = 2.25$

*Pikët totale 2.25 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## V.11. Treguesi: Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar nga gjimnazi<sup>8</sup>

Anketimi i prindërve bëhet me qëllim marrjen e mendimeve të tyre në lidhje me përvojën e përgjithshme mbi cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla, si dhe ndihmon për të qartësuar dhe bashkëpunimin mes prindërve dhe gjimnazit. Përgjigjet e anketës vlerësohen sipas një shkalle në 5 nivele.

Anketa hartohet nga ASCAP-i dhe zhvillohet me 20% të prindërve. Kur nuk sigurohet ky prag minimal, treguesi vlerësohet me zero pikë.

Anketa me prindërit lidhet me:

- mikpritjen e gjimnazit;
- informimin e vazhdueshëm për rezultatet e fëmijës së tyre;
- pjesëmarrjen e tyre në planifikimet dhe vendimmarrjet e gjimnazit;
- mbështetjen e sjelljeve pozitive nga gjimnazi;
- sigurinë në gjimnaz;
- gjithëpërfshirjen e fëmijëve të tyre, sipas nevojave dhe interesave;
- cilësinë e mësimdhënies;
- etj.

---

<sup>8</sup> Në shtojcë gjendet anketa për treguesin “Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar nga gjimnazi”.



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Anketa duhet të ofrojë dëshmi të besueshme, për këtë arsye prindërit duhet të përzgjidhen në mënyrë rastësore, duke përfshirë prindërit e nxënësve të të gjitha niveleve dhe të të gjitha klasave/paraleleve.

Anketa zhvillohet nëpërmjet platformave online, gjë e cila lehtëson përpunimin e tyre. Anketa nuk duhet të zgjasë më shumë se 15-20 minuta. Aty ku prindërit nuk kanë mundësi të përdorimit të pajisjeve digjitale personale, i kërkohet gjimnazit t'u vendosë në dispozicion kompjuterët e shkollës. Nëse edhe kjo nuk është e mundur, atëherë ato zhvillohen me formularë të printuar.

Grupi i vlerësimit duhet të marrë masat për të mbrojtur identitetin e prindërve. Anketa mund të ndryshojë ndër vite sipas përparësive dhe kërkesave të MAS-it.

*Vlera e këtij treguesi gjendet duke shumëzuar përqindjen e përgjigjeve të nivelit 4 (shumë dakord) dhe 5 (plotësisht dakord) të anketës/pyetësorit të zhvilluar me prindërit, me peshën 5% të treguesit, pjesëtuar me 100.*

## **Shembull:**

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë. U realizuan anketa me 20% të prindërve të nxënësve të gjimnazit. Për të gjetur përqindjen e përgjigjeve të nivelit 4 dhe 5 të anketës së zhvilluar me prindërit, gjendet mesatarja aritmetike e përqindjes së përgjigjeve, për të cilat prindërit janë përgjigjur *dakord* dhe *plotësisht dakord*, përkatësisht:

$$\text{Përqindja} = \frac{P_1 + P_2 + P_3 + \dots + P_{24} + P_{25}}{25}$$

Ku me  $P_1 + P_2 + P_3 + \dots + P_{24} + P_{25}$ , janë shënuar përqindjet e përgjigjeve të nivelit 4 (*dakord*) dhe 5 (*plotësisht dakord*) të secilit pohim. Nga llogaritjet, rezulton se 83% e prindërve janë përgjigjur

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

në nivelin 4 (*dakord*) dhe 5 (*plotësisht dakord*) në lidhje kënaqësinë e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga gjimnazi.

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

<b>Përqindja e mesatares aritmetike e përgjigjeve të nivelit 4 dhe 5 të anketës me prindërit.</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
83%	5%	<b><math>83 \times 5 / 100 = 4.15</math></b>

*Pikët totale 4.15 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## **V.12. Ruajtja e notës mesatare të gjimnazit nga nxënësit me/mbi notën 9-të në vitin e parë të universitetit**

Gjurmimi i rezultateve të nxënësve, tashmë studentë në universitet, është i dobishëm për të ndihmuar në përmirësimin e rezultateve të gjimnazit, procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe drejtimin dhe menaxhimin afatgjatë të tij.

Rezultatet e gjurmimit shërbejnë për të rritur ndërgjegjësimin e personelit mësimdhënës për rezultatet e mësimdhënies dhe të nxënit dhe për t'i krahasuar ato ndër vite. Gjithashtu, ndihmojnë në përmirësimin e këshillimit të karrierës, duke rritur bashkëpunimin me universitetet, për një planifikim sa më të mirë të së ardhmes së maturantëve.

Rezultatet e gjurmimit shërbejnë gjithashtu për t'u krahasuar me gjimnazet e tjera në nivel kombëtar, për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të gjimnazit.

*Vlera e treguesit gjendet duke shumëzuar përqindjen e nxënësve me /mbi notën 9-të që kanë ruajtur notën mesatare të gjimnazit në vitin e parë të universitetit, me peshën 10% të treguesit, pjesëtuar me 100.*

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## Shembull:

Gjimnazi “A” ka 50 maturantë me notë mesatare me/mbi notën 9-të, sipas VKM-së, që kanë vazhduar universitetin. Numri i këtyre nxënësve që kanë ruajtur notën mesatare të gjimnazit në përfundim të vitit të parë të universitetit është 21. Përqindja e nxënësve është  $21/50=42\%$ .

*Përlllogaritja e numrit të pikëve për treguesin:*

Përqindja e nxënësve me/mbi notën 9-të që kanë ruajtur notën mesatare të gjimnazit në vitin e I të universitetit	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
42%	10%	$42 \times 10 / 100 = 4.2$

*Pikët totale 4.2 tregojnë vlerën e këtij treguesi.*

## *Përlllogaritja e pikëve totale të gjimnazit “A”*

Për vlerësimin e gjimnazit, mblidhen vlerësimet e të gjithë treguesve dhe shuma e tyre përcakton pikët totale për renditjen e gjimnazit, përkatësisht:

Gjimnazi	Infrastruktura	Kualifikimi i mësuesve	Shtrirja e kurrikulës	Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve	Mirëqenia e nxënësve	Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të MSh	Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje në MSh	Ruajtja e notës mesatare e lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të nxënësve të klasës së 12-të në provimet e MSh	Shkalla e diplomimit	Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga gjimnazi dhe nxënësit	Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar	Ruajtja e notës mesatare të gjimnazit nga nxënësit me/mbi notën 9-të në vitin e parë të universitetit	Numri i pikëve totale
“A”	4	1.3	2.69	19.5	8.76	1.83	2.9	5.4	8.4	2.25	4.15	4.2	<b>65.38</b>

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## VI. RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Renditja kombëtare e gjimnazeve realizohet nga ASCAP-i, sipas tri kategorive, publike, private dhe ndërkombëtare. Për vlerësimin e treguesve merren të dhënat e fundit të vitit shkollor, për treguesit që vlerëson ZVAP-ja, ndërsa treguesit që vlerëson ASCAP-i merren rezultatet në vlerësimet e plota apo tematike në tri vitet e fundit.

Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë pranë ASCAP, mbledh të gjitha të dhënat e vlerësimit të 12 treguesve për çdo gjimnaz.

Gjimnazet renditen bazuar në rezultatin përfundimtar të shumës totale të vlerësimeve të secilit tregues.

Renditja bëhet duke filluar nga gjimnazi me shumën më të madhe të pikëve, në rendin zbritës.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## Shembull:

Gjinnazet “A”, “B”, “C” dhe “D” janë vlerësuar si në tabelën e mëposhtme. Gjinnazi “C” ka shumën më të madhe të pikëve (81.55) dhe zë vendin e 1.

	<b>RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE</b>													
	Gjinnazi	Infrastruktura	Kualifikimi i mësuesve	Shtrirja e kurrikulës	Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxëniet	Mirëqenia e nxënësve	Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të MSh	Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje në MSh	Ruajtja e notës mesatare e lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të nxënësve të klasës së 12-të në provimet e MSh	Shkalla e diplomimit	Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga gjinnazi dhe nxënësit	Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar	Ruajtja e notës mesatare të gjinnazit nga nxënësit me/mbi notën 9-të në vitin e parë të universitetit	<b>Numri i pikëve totale</b>
1	C	4.7	3.5	4.6	23.89	9.49	4.21	3.96	5.62	9.32	2.9	4.84	4.5 <sub>2</sub>	<b>81.55</b>
2	B	4.53	2.1	4.2	22.24	9.1	3.4	3.25	5.43	8.85	2.56	4.59	4.3	<b>74.55</b>
3	A	4	1.3	2.69	19.5	8.76	1.83	2.9	5.4	8.4	2.25	4.15	4.2	<b>65.38</b>
4	D	4.2	1.29	2.34	15.17	7.74	2.96	2.87	5.1	7.77	1.05	3.98	3.9 <sub>2</sub>	<b>58.39</b>
5	E	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## VI.1. Kalendari i veprimtarive

- ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-et dhe vlerësuesit e certifikuar realizon vlerësime tematike/ të plota tek të gjitha gjimnazet çdo tri vite.
- Drejtori i gjimnazit dorëzon në ZVAP të dhënat e kërkuara për vlerësimin e treguesve nga ZVAP-ja, brenda datës 20 korrik të vitit që realizohet renditja e gjimnazeve.
- ZVAP-ja-dorëzon në ASCAP të dhënat e kërkuara brenda muajit gusht të vitit që realizohet renditja e gjimnazeve.
- ASCAP-i në bashkëpunim me MAS-in, ZVAP-të dhe universitetet, llogarit për çdo gjimnaz përqindjen e nxënësve me mbi notën 9-të, sipas VKM-së, që kanë ruajtur notën mesatare të gjimnazit në përfundim të vitit të parë të universitetit brenda muajit gusht, të vitit që realizohet renditja e gjimnazeve.
- ASCAP-i shpall renditjen e kombëtare të gjimnazeve brenda muajit shtator, të vitit që realizohet renditja e gjimnazeve.
- MAS-i brenda muajit tetor shpall dhe vlerëson 10 gjimnazet e suksesshme në nivel kombëtar, të vitit që realizohet renditja e gjimnazeve.

## VII. BAZA LIGJORE

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
4. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
5. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, 2021-2026.
6. Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013.
7. VKM-ja 319, datë 12.04.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të IAP-ve”.
8. VKM-ja nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.
9. VKM-ja nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit parauniversitar (ASCAP)”.
10. VKM-ja nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)”.
11. Udhëzimi i MAS-it, nr. 15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.
12. Udhëzimi nr. 25, datë 02.08.2013, “Për organizimin e funksionimin e qeverisë së nxënësve”, i ndryshuar.
13. Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

14. Udhëzimi nr. 26, datë 02.08.2013, “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve”.
15. Udhëzimi katërministor midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 10, datë 25.02.2015, “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.
16. Udhëzimi i MAS-it, nr. 12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”.
17. Udhëzimi i MAS-it, nr. 21, datë 09.07.2015, “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz”.
18. Udhëzim i MAS-it, nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
19. Udhëzimi i MAS-it, nr. 30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
20. Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.
21. Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
22. Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
23. Udhëzimi i MAS-it, nr. 2, datë 08.02.2023, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
24. Udhëzimi i MAS-it, nr. 16, datë 28.07.2021, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.



# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

25. Udhëzimi i MAS-it, nr.10, datë 06.05.2022, për “Ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të Rrjetit kombëtar të monitoruesve, vlerësuesve dhe vlerësuesve me bazë rrishtu për institucionet arsimore parauniversitare”.
26. Udhëzimi i MAS-it, nr. 17, datë 05.07.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
27. Urdhër nr. 344, datë 19.08.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”.
28. Urdhër nr. 195, datë 25.04.2016, “Për miratimin e dokumentit ‘Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen-Profil i mësuesit gjithëpërfshirës”.
29. Urdhër nr. 477, datë 30.09.2019, “Për miratimin e standardeve profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar”.
30. Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU e AML, IZHA, 2016.
31. Standardet profesionale të vlerësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare, ASCAP, 2021.
32. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2014.
33. Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së IAP-së, ASCAP 2020.
34. Udhëzuesi për Vlerësimin e Jashtëm dhe të Brendshëm të IAP-së, ASCAP 2020.
35. Metodologjia e Vlerësimit të Brendshëm të IAP-së, ASCAP 2020.
36. Metodologjia e Vlerësimit të Jashtëm të IAP-së, ASCAP 2020.
37. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 4661/1 prot., datë 18.6.2015, “Për implementimin e projektit ‘Mësime të shahut në IAP’”, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut.
38. Marrëveshja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Mediat Audiovizive dhe Kulturën e Komisionit Evropian.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

39. Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
40. “Standardet e IAP-së si Qendër Komunitare” dhe udhëzuesi për “IAP-të Qendër Komunitare”, tetor 2014.
41. Korniza e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, nr. 5563, datë 23.07.2015).
42. Nivelet e arritjes së kompetencave, shkalla V dhe VI, IZHA, tetor 2018.
43. Udhëzues kurrikular lëndor në Arsimin e Mesëm të Lartë, IZHA, 2018.
44. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz, IZHA, maj 2018.

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

## VIII. BIBLIOGRAFIA

- <https://www.usnews.com/education/best-high-schools/articles/rankings-faq>
- [http://www.hkpep.com/2013/index\\_en.php#1](http://www.hkpep.com/2013/index_en.php#1)
- <https://www.deutscher-schulpreis.de/auswahlverfahren>
- <https://dera.ioe.ac.uk/11232/2/Twelve.pdf>
- <https://www.education.gouv.fr/methodologie-des-indicateurs-de-resultats-des-lycees11948>
- [https://www.schoolguide.co.uk/league\\_tables/secondary#how weRankSecondarySchools](https://www.schoolguide.co.uk/league_tables/secondary#how weRankSecondarySchools)
- <https://eduscopio.it/dati-e-metodologia>
- <https://www.matrix.edu.au/beginners-guide-to-hsc-high-school-rankings/>
- <https://www.danskerhverv.dk/engelsk>
- <https://licea.perspektye.pl/2022/methodology/ranking-liceow-ogolnoksztalcacych-2022>
- <https://www.phillymag.com/news/2022/08/17/top-schools-methodology-2022/>
- [https://docshare.tips/standard-indicators-for-evaluation-and-ranking-of-damavand-high-schools-in-terms-of-inputs-and-outputs\\_62d961271c4f85ab168b456d.html](https://docshare.tips/standard-indicators-for-evaluation-and-ranking-of-damavand-high-schools-in-terms-of-inputs-and-outputs_62d961271c4f85ab168b456d.html),
- <http://aei.pitt.edu/42406/1/A6503.pdf>,
- [https://www.researchgate.net/publication/347940654\\_Ranking\\_high\\_schools\\_using\\_university\\_student\\_performance\\_in\\_Italy](https://www.researchgate.net/publication/347940654_Ranking_high_schools_using_university_student_performance_in_Italy)
- <https://www.schoolschoice-edu.net/rankingschools>
- <https://scholaroo.com/report/state-education-rankings/>
- <https://www.greatschools.org/gk/ratings/#wights>
- <https://link.springer.com/article/10.1007/s40888-020-00208-2>
- [file:///C:/Users/user/Downloads/948\\_Macarellieg6-22.pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/948_Macarellieg6-22.pdf)
- <file:///C:/Users/user/Downloads/SSRN-id3432393.pdf>
- <https://www.niche.com/about/methodology/best-school-districts/>

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

- <https://www.niche.com/k12/rankings/methodology/>
- <https://www.scribd.com/document/238785187/>
- <https://wtop.com/education/2021/04/u-s-news-releases-2021-best-high-schools-rankings/>
- <https://data.oecd.org/eduresource/education-spending.htm>
- <https://data.oecd.org/searchresults/?r=%2Bf%2Ftype%2Findicators&r=%2Bf%2Ftopics%2Feducation>

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## IX. SHTOJCA

### IX.1. Formati i vlerësimit të infrastrukturës së gjimnazit

Nr.	Formati i vlerësimit të infrastrukturës së gjimnazit	Pikë
1.	Gjimnazi është i rrethuar me kangjella/mur.	
2.	Mjedisi i jashtëm i gjimnazit është i mirëmbajtur, i gjelbëruar dhe shplodhës.	
3.	Klasat janë me sipërfaqe jo më të vogël se 1.4-1.6m <sup>2</sup> për nxënës.	
4.	Hapësirat e tavolinave të nxënësve dhe distanca mes tyre, janë sipas standardeve.	
5.	Qëndrimi dhe ulja e nxënësve në klasë nga rreshti i parë te dërrasa është jo më pak se 2 m <sup>2</sup> .	
6.	Këndi i të parit të nxënësit është jo më shumë se 30°.	
7.	Klasat ndriçohen me dritë natyrale të mjaftueshme në krahun e majtë të nxënësve.	
8.	Sipërfaqja e dritareve të klasave zë 1/5 ose 1/6 të sipërfaqes së dyshemesë.	
9.	Gjimnazi ka klasa laboratorike (kimi, biologji, fizikë, informatikë, gjuhë e huaj) me hapësirë jo më pak se 2.2 m <sup>2</sup> për nxënës, ku janë ekspozuar rregullat e sigurisë.	
10.	Laboratorët/kabinetet janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe materialet mësimore-didaktike.	
11.	Gjimnazi ka mjedis biblioteke me sipërfaqe jo më pak se 0.15 m <sup>2</sup> për nxënës.	
12.	Gjimnazi ka mjedise shumëpërdorimëshe (sallë mbledhjesh/takimesh/simpoziumesh).	
13.	Gjimnazi ka sallë (palestër) për edukimin fizik e cila është jo më e vogël se 405 m <sup>2</sup> .	
14.	Gjimnazi ka 2 mjedise të vetë-ndihmës (veshje/zhveshje) me sipërfaqe 20 m <sup>2</sup> secila.	
15.	Gjimnazi ka sallë aktivitetesh për nxënësit me 0.25m <sup>2</sup> /nx dhe jo më pak se 70 m <sup>2</sup> .	
16.	Gjimnazi ka hapësirë administrative për drejtorin, e cila është jo më pak se 25 m <sup>2</sup> .	
17.	Gjimnazi ka hapësirë administrative për nëndrejtorin me sipërfaqe jo më pak se 16 m <sup>2</sup> .	

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

18.	Gjimnazi ka sallë mësuesish me sipërfaqe jo më pak se 30 m <sup>2</sup> .	
19.	Gjimnazi ka zyrë sekretarie me sipërfaqe jo më pak se 16 m <sup>2</sup> .	
20.	Gjimnazi ka mjedis të veçantë për personelin ndihmës, i cili është 2 m <sup>2</sup> për çdo person.	
21.	Gjimnazi ka dhomë për ofrimin e shërbimit mjekësor, me sipërfaqe jo më pak se 17 m <sup>2</sup> .	
22.	Gjimnazi ka mjedis të veçantë për ofrimin e shërbimit psiko-social me sipërfaqe minimale 18 m <sup>2</sup> .	
23.	Mjediset komunikuese, hyrjet, hollet, korridoret, shkallët, rampa janë sipas standardeve zyrtare.	
24.	Gjimnazi ka impiantin e furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë sanitar.	
25.	Gjimnazi ka impiantin e shkarkimit të ujërave të zeza, ujërave të shiut dhe ujërave të bardha.	
26.	Gjimnazi ka hapësira të jashtme të mjaftueshme për zbatimin e kërkesave të kurrikulës së edukimit fizik (fushë volejboll, basketbolli, futboll, tenisi dhe kënd gjimnastikor).	
27.	Orenditë dhe pajisjet (tavolinat, karriget, stolat, dërrasat e shkrimit, dollapët lavamanët, njësitë fikse të mureve, ventilatorët e avujve, veglat dhe pajisjet laboratorike, kompjuterët, printerët, skanerët, kolltukët, varësit special për harta dhe fotografi, pajisjet audovizuale etj.), janë sipas karakteristikave dhe përmasave të projektimit të ndërtesës së gjimnazit.	
28.	Ndërtesa e gjimnazit siguron qasjen e papenguar të lëvizjes, qëndrimit dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta.	
29.	Numri i tualeteve është në raport me numrin e nxënësve dhe të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta.	
30.	Gjimnazi ka impiantin e mbrojtjes kundër zjarrit (SMKZ) dhe mjete portative (bombola) për shuarjen e zjarrit.	
31.	Gjimnazi ka impiantin e ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit.	
32.	Gjimnazi ka shkallë emergjence në çdo kat.	
33.	Në mjediset e gjimnazit janë vendosur shenja dalluese dhe udhëzues mbi veprimet përkatëse në rast ngjarjesh të jashtëzakonshme, si dhe janë afishuar në mjediset e saj numrat e emergjencës, policisë, zjarrfikësve dhe të urgjencës,	
34.	Mjediset e brendshme dhe të jashtme të gjimnazit nuk janë të zëna me objekte që pengojnë lëvizjen e nxënësve në ngjarje të jashtëzakonshme.	
35.	Gjimnazi ka afishuar në mjediset e tij shenjat dalluese që ndalojnë pirjen e duhanit, pijeve alkoolike, drogës dhe përdorimin e telefonit celular në të gjitha mjediset e saj.	
<b>Pikë totale</b>		

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## IX.2. Formati i vlerësimit të treguesve të gjimnazit nga ZVAP-ja

Gjimnazi publik/privat/ndërkombëtar	
ZVAP	
Adresa	
Email	
Telefon	
Numri i nxënësve	
Numri i mësuesve	
Raporti nxënës/mësues	

**Treguesi: Infrastruktura**

Infrastruktura	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
	5%	

**Treguesi: Vlerësimi i mësuesve në provimet e kualifikimit**

Vlerësimi i mësuesve në provimet e kualifikimit	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
	5%	

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Treguesi: Shtrirja e kurrikulës

<b>Përqindja e lëndëve me zgjedhje që ofron gjimnazi në klasën e 12-të, kundrejt lëndëve sipas planit mësimor</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
	5%	

Treguesi: Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9 të përshkallëzuar në provimet e detyruara të maturës shtetërore në sesionin e parë

<b>Përqindja e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të përshkallëzuar në provimet e detyruara në MSh, në sesionin e parë</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve për këtë tregues</b>
	5%	

Treguesi: Vlerësimi i maturantëve me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje të maturës shtetërore, në sesionin e parë

<b>Përqindja e nxënësve të vlerësuar me/mbi notën 9-të të përshkallëzuar në provimet me zgjedhje në MSh, në sesionin e parë</b>	<b>Pesha e treguesit</b>	<b>Numri i pikëve të treguesit</b>
	5%	

Treguesi: Ruajtja e notës mesatare të nxënësve të klasës së 12-të në lëndët e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore



## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

Përqindja e nxënësve të klasës së 12-të që kanë ruajtur notën mesatare të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
	10%	

### Treguesi: Shkalla e diplomimit

Përqindja e shkallës së diplomimit	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
	10%	

### Treguesi: Çmimet kombëtare e ndërkombëtare të fituara nga shkolla dhe nxënësit

Përqindja e çmimeve në nivel kombëtar	Numri i çmimeve ndërkombëtare	Pesha e treguesit	Numri i pikëve të treguesit
		5%	

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## IX.3. Anketa për treguesin “Mirëqenia e nxënësve”

I/e dashur nxënës/e,

Jemi duke vlerësuar mirëqenien tuaj të siguruar nga gjimnazi që ti frekuenton. Këndvështrimet tuaja janë shumë të rëndësishme për ne. Të lutem, lexo me kujdes çdo pyetje dhe vendos X në përgjigjen që mendon se është më e drejtë për shkollën tënde.

Ajo që do të na thuash do të jetë plotësisht e fshehtë. Edhe ti nuk duhet të ndash përgjigjet me askënd. Vlerësuesit do të jenë të gatshëm të flasin për çdo gjë me ju.

Faleminderit për përgjigjet.

Nr.	Pohime	Plotësisht dakord	Dakord	Pjesërisht dakord	Nuk jam dakord	Nuk e di
<b>Drejtimi dhe menaxhimi</b>						
1.	Unë ndihem i sigurt në këtë gjimnaz.					
2.	Në gjimnazin që ndjek respektohen rregullat e mbrojtjes së shëndetit, të sigurisë dhe të mjedisit nga nxënësit dhe punonjësit arsimorë.					
3.	Ne jemi të informuar dhe të trajnuar për veprimet në rastet e emergjencës.					
4.	Shenjat e evakuimit në raste alarmi apo fatkeqësisht janë të vendosura qartë dhe të kuptueshme.					
5.	Unë ndihem i kënaqur me shërbimet që ofron gjimnazi (mjeku, psikologu/punonjësi social, oficeri i sigurisë etj.).					
6.	Faqja e internetit të gjimnazit jep informacion të dobishëm.					

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

7.	Unë jam informuar për të drejtat e detyrimet e mia, rregulloren e brendshme, si dhe kurrikulën e ofruar nga gjimnazi.				
8.	Mua më janë plotësuar preferencat e mia për lëndët me zgjedhje.				
9.	Unë ndihem i përfshirë dhe i përfaqësuar në organizmat e gjimnazit.				
10.	Zëri im dëgjohet në gjimnaz për përmirësimin e procesit mësimor dhe edukativ.				
11.	Kur kam nevojë për informacion e di gjithmonë kë të kontaktoj.				
12.	Drejtuesit e gjimnazit janë të gatshëm për të dëgjuar problemet e mia dhe për t'u dhënë zgjidhje.				
13.	Gjimnazi që unë ndjek është i pajisur me laboratorë, mjete/materiale mësimore didaktike dhe pajisje teknologjike në funksion të procesit mësimor.				
14.	Gjimnazi që unë ndjek është i hapur dhe i përkushtuar ndaj nismave dhe projekteve të ndryshme.				
15.	Drejtuesit e gjimnazit më mbështetin dhe ofrojnë hapësira për veprimtaritë e organizuara nga ne nxënësit, si gjatë orarit mësimor ashtu edhe pas tij.				
16.	Unë e di që ky gjimnaz do të më japë një përgatitje të mirë bazë, për të vazhduar studimet dhe/ose për hyrë në tregun e punës.				
<b>Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit</b>					
17.	Mësuesit na sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë nxënësit, duke qenë të drejtë dhe të paanshëm.				
18.	Mësuesit më kanë qartësuar për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës, në përputhje me nevojat, stilet e të nxënit dhe				

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	përvojat mësimore të mia.					
19.	Mësuesit kanë bashkëpunuar me prindërit dhe ne nxënësit për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës.					
20.	Mjedisi fizik i të nxënësve në këtë gjimnaz është funksional dhe i përshtatshëm për nevojat e mia.					
21.	Të gjithë mësuesit përdorin metodologji dhe teknika të larmishme dhe ndërvepruese gjatë orës së mësimin.					
22.	Metodat dhe teknikat e përdorura nga mësuesit janë të vlefshme dhe efektive për mua.					
23.	Laboratorët, mjetet/materialet mësimore didaktike dhe teknologjia e informacionit përdoren me efektivitet në funksion të mësimdhënies dhe nxënies.					
24.	Mësuesit më përfshijnë vazhdimisht në veprimtaritë e realizuara gjatë orës mësimore.					
25.	Mësuesit më ndihmojnë të jap më të mirën që mundem.					
26.	Mësuesit japin detyra shtëpie individuale ose në grup, duke na i sqaruar ato dhe duke mos na mbingarkuar.					
27.	Mësuesit realizojnë bashkë me ne nxënësit projekte lëndore, ndër-lëndore.					
28.	Mësuesit flasin vazhdimisht me mua për mënyrën se si të përmirësohem.					
29.	Mësuesit u ofrojnë nxënësve në vështirësi në të nxënë konsultime për përmirësimin e arritjeve.					
30.	Mësuesit më nxitin vetëvlerësimin, duke më bërë të kuptoj mundësitë dhe aftësitë e mia.					
31.	Testet/detyrat përmbledhëse të lëndëve të ndryshme shpërndahen në kohë, në mënyrë të ekuilibruar.					
32.	Mësuesit më kanë shpjeguar në mënyrë të qartë dhe					

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	transparente format dhe kriteret e vlerësimit.					
33.	Mësuesit më kanë vënë në dijeni me shkrim/me gojë për rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare.					
34.	Përdorimi i SMIP-it është i përshtatshëm dhe i dobishëm.					
<b>Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve</b>						
35.	Mësuesit janë të hapur për dialog me ne nxënësit.					
36.	Marrëdhëniet mes nxënësve të gjimnazit janë miqësore dhe tolerante, duke krijuar një atmosferë të kënaqshme.					
37.	Mësuesit nxitin marrëdhënie pozitive (dëgjim, dialog) ndërmjet nxënësve.					
38.	Nxënësit e gjimnazit respektojnë rregullat.					
39.	Unë ndihem i mbrojtur nga dhuna dhe abuzimi në gjimnaz.					
40.	Në gjimnaz ka gjithmonë një person me të cilin mund të flas nëse jam i mërzitur apo i shqetësuar.					
41.	Mësuesit përdorin metoda efektive për parandalimin dhe eliminimin e bullizmit.					
42.	Drejtuesit e gjimnazit realizojnë rregullisht veprimtari ndërgjegjësuere për parandalimin dhe eliminimin e përdorimit të drogës, alkoolit, duhanit dhe shfaqjeve të tjera të ndaluara.					
43.	Qeveria e nxënësve realizon veprimtari për përmirësimin e klimës në gjimnaz.					
44.	Stafi i gjimnazit më ndihmon të kem besim në vetvete.					
45.	Gjimnazi ofron veprimtari jashtëskollore, nisma apo projekte të dobishme, që u përgjigjen nevojave dhe interesave të mia.					
46.	Informacioni në lidhje me veprimtaritë jashtëskollore,					

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	nismat apo projektet më është komunikuar në mënyrë të qartë dhe shteruese nga mësuesit.					
47.	Gjimnazi ku unë mësoj më ka plotësuar dëshirat e mia për pjesëmarrjen në veprimtaritë jashtëshkollore, nismat apo projektet.					
48.	Gjimnazi që unë ndjek ofron veprimtari që mbështesin talentet (olimpiada, gara, konkurse etj.).					
49.	Gjimnazi zhvillon veprimtari në lidhje me këshillimin e karrierës.					
50.	Jam i kënaqur që ndjek këtë gjimnaz.					

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

## IX.4. Anketa për treguesin “Kënaqësia e shërbimit arsimor të ofruar”

I dashur prind,

Ju kërkohet të shprehni mendimet për shkollën e fëmijës suaj dhe marrëdhëniet e tij me shokët/shoqet e klasës dhe mësuesit. Përgjigjet që ju do të jepni janë shumë të dobishme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofron shkolla. Përgjigjet tuaja do të trajtohen në mënyrë të fshehtë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pasi të keni lexuar pohimet e mëposhtme, ju duhet të zgjidhni një prej varianteve që plotëson më mirë mendimin tuaj lidhur me atë pohim duke e shënuar me shenjën (X).

*Sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme në lidhje me gjimnazin që fëmija juaj ndjek?*

Nr.	Pohime	I pajtohem		I jepem besim		Nuk jam dakord	Nuk e di
		dakord	Dakord	dakord	Dakord		
1.	Unë ndihem i qetë dhe i lehtësuar që fëmija im ndjek këtë gjimnaz.						
2.	Fëmija im ndihet i sigurt në gjimnaz.						
3.	Mjediset e gjimnazit janë të pastra, të mirëmbajtura dhe mikëpritëse.						
4.	Unë ndihem i kënaqur me shërbimet që ofron gjimnazi (mjeku, psikologu/punonjësi social, oficeri i sigurisë etj.).						
5.	Stafi i gjimnazit më ka informuar për legjislacionin arsimor në fuqi, rregulloren e brendshme dhe kurrikulën që ofron gjimnazi.						
6.	Unë ndihem i përfshirë dhe i përfaqësuar në organizmat e gjimnazit, si dhe grupet e ndryshme të punës të ngritura në gjimnaz.						

## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

<b>7.</b>	Stafi i gjimnazit ka marrë në konsideratë shqetësimet dhe sugjerimet e mia, duke më bërë pjesë vendimmarrje.					
<b>8.</b>	Mësuesit u sigurojnë mundësi të barabarta arsimit të gjithë nxënësve, duke qenë të drejtë dhe të paanshëm.					
<b>9.</b>	Mësuesit marrin parasysh nevojat dhe interesat e fëmijës tim në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës.					
<b>10.</b>	Mësuesit ofrojnë plane të personalizuara për nxënësit me nevoja të veçanta (me vështirësi në të nxënë, talentet dhe me nevoja të veçanta).					
<b>11.</b>	Mësuesit përdorin rregullisht laboratorët, mjetet mësimore dhe teknologjinë e informacionit.					
<b>12.</b>	Mësuesit përdorin metoda dhe teknika të larmishme për të lehtësuar nxënien e fëmijës tim.					
<b>13.</b>	Mësuesit i japin detyra shtëpie individuale ose në grup fëmijës tim, duke mos e mbingarkuar.					
<b>14.</b>	Unë jam i kënaqur nga mënyra e organizimit dhe menaxhimit të takimeve që zhvillojnë mësuesit me prindërit.					
<b>15.</b>	Unë kam marrë informacione të dobishme në lidhje me arritjet akademike dhe joakademike të fëmijës tim në takimet me prindër dhe nëpërmjet SMIP-it.					
<b>16.</b>	Fëmija im flet me respekt për mësuesit e tij.					
<b>17.</b>	Fëmija im është i kënaqur nga marrëdhëniet me shokët e klasës.					
<b>18.</b>	Fëmija im ndihet i mbrojtur nga çdo lloj forme dhune apo abuzimi në gjimnaz.					
<b>19.</b>	Unë di me kë të flas nëse fëmija im pëson çdo formë dhune apo abuzimi.					
<b>20.</b>	Unë kam marrë pjesë në veprimtari të zhvilluara nga gjimnazi për parandalimin dhe eliminimin e dhunës, bullizmit dhe					



## RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

	abuzimit.					
21.	Unë kam marrë pjesë në veprimtari ndërgjegjësuese të zhvilluara nga gjimnazi, për parandalimin e mospërdorimit të drogës, alkoolit, duhanit dhe shfaqjeve të tjera të ndaluara.					
22.	Gjimnazi organizon veprimtari jashtëskollore dhe zbaton nisma të ndryshme, për siguruar zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës tim.					
23.	Fëmijës tim i është dhënë mundësia të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë jashtëskollore dhe nismat e ndryshme që ka dëshiruar.					
24.	Fëmija im nuk ka shqetësime specifike për gjimnazin, për bashkëmoshatarët apo për mësuesit.					
25.	Unë do t'ia rekomandoja këtë gjimnaz një prindi tjetër.					

# RENDITJA KOMBËTARE E GJIMNAZEVE

---

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar**

 **Rruga "Naim Frashëri" Nr. 37, Tiranë, Shqipëri**

 **(+355) 4256440 / 4256441**

 **[sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al)**

**[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)**

 **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar**

 **ascapalbania**